



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i raportit vjetor për vitin 2018 i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, nga drejtori ekzekutiv i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, zoti Janez Kopac

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani dhe Nimet Musaj.

Mungojnë:

Lefter Koka.

Të ftuar:

Janez Kopac – drejtori ekzekutiv i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

Barbora Jaksova –

Gjergj Simaku – Drejtor i Politikave dhe Strategjisë së Zhvillimit të Energjisë dhe Industrisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Mirjana Xhaferri – përfaqësuese nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Blendi Bushati – Drejtor i Divizionit të Programimit dhe Menaxhimit Strategjik në

KESH

Erideta Bashi –Drejtoreshë e Operacioneve Tregtare në KESH

Petrit Ahmeti – kryetar i Bordit të Komisionerëve në ERE

Maksim Shuli – komisioner në ERE

Erjola Sadushi – komisionere në ERE

Rajmonda Islamaj – Komisionere në ERE

Entela Çipa – Drejtoreshë në Agjencinë e Eficiencës së Energjisë

Fatbardha Bytyci – përfaqësuese nga OST-ja

Erion Tase – përfaqësues nga Akademia e Studimeve Politike

Hapet mbledhja

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Të nderuar anëtarë të Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese,

Kam kënaqësinë të prezantoj drejtorin ekzekutiv të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, zoti Kopac, i cili ka ardhur, siç është bërë traditë, për të bërë prezantimin e raportit për implementimin e reformave të paketës së tretë të energjisë nga Shqipëria për vitin 2018.

Tashmë është kthyer në traditë që vetë drejtori ekzekutiv i Sekretariatit vjen përpara këtij komisioni të bëjë prezantimin e raportit.

Po them dy fjalë meqenëse kjo është edhe mbledhja e parë për disa deputetë të rinj, të cilëve u uroj punë të mbarë në parlament dhe në këtë komision.

Komuniteti i Energjisë është një organizatë ndërkombëtare, objektivi i së cilës është krijimi i një tregu energjie të integruar dhe të qëndrueshëm paneuropian. Kjo organizatë është ngritur dhe funksionon që nga viti 2005, pra nga Traktati i Athinës. Komuniteti i Energjisë nga njëra anë sjell Bashkimin Europian dhe nga ana tjetër sjell nënpalët kontraktore që janë: Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Gjeorgjia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Ukraina, me qëllim zgjerimin e tregut të brendshëm energjetik të Bashkimit Europian në Europën Juglindore, duke përcaktuar një kuadër ligjor rregullator. Sigurisht që ka edhe qëllime të tjera, si: nxitja e investimeve, krijimi i një tregu të integruar të energjisë, përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji dhe përmirësimi i situatës mjedisore, meqenëse është e lidhur ngushtë me investimet në energjetikë.

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me këtë sekretariat në hartimin dhe shqyrtimin e ligjeve, si: “Për sektorin e energjisë elektrike”, “Për eficiencën e energjisë”, “Për energjinë e rinovuese”, “Për gazin natyror” e të tjerë, gjithashtu është kërkuar ekspertiza e Sekretariatit për çështje që lidhen me sektorin e energjisë dhe të gazit.

Nuk po zgjatem më tepër, por po ia kaloj fjalën drejtorit ekzekutiv të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për të bërë prezantimin e raportit të zbatimit të reformave nga Shqipëria për vitin 2018. Këtu marrin pjesë institucione apo korporatat energjetike, palë të interesuara në këtë sektor dhe për këtë raport.

Çdo anëtar i komisionit ka përpara raportin në shqip. Prezantimi do të bëhet në anglisht, faqe mbas faqe dhe secili prej nesh do ta ndjekë në shqip, për të mos pasur përkthim konsektiv. Nëse ka ndonjë paqartësi, mund ta ndërpresim prezantimin dhe të kërkojmë sqarim. Në fund të raportit do të vijojmë me pyetje, përgjigje dhe diskutime.

Zoti Kopac, faleminderit që keni ardhur!

Fjala për ju.

Janez Kopac – (*Prezantimi bëhet në anglisht*)

Në sektorin e gazit situata nuk mund të quhet një çështje e nxehtë, sepse në Shqipëri nuk është bërë ende gazifikimi, kemi vetëm TAP-in, që kalon përmes Shqipërisë, dhe mjedisi ligjor fushën e gazit është shumë më i mirë. Gjithashtu, është e nevojshme që të miratohen disa akte të tjera, megjithatë nuk janë emergjente dhe shumë të rëndësishme pasi, siç e thashë, ende nuk kemi një furnizim me gaz në Shqipëri që duhet rregulluar.

Slide-i i ardhshëm bën fjalë për 3 rregullatorët: ERE, Autoriteti i Konkurrencës dhe ai i ndihmës shtetërore. Në raportin tonë ne vlerësojmë punën dhe kontributin e rregullatorëve, siç e shikoni edhe në *slide* ERE-ja është vlerësuar shumë më lart krahasuar me dy autoritetet e tjera. Ky vlerësim për ERE-n është bërë pasi ne e konsiderojmë se ka qenë i suksesshëm në miratimin e disa rregullave, por pika e dobët e ERE-s është mungesa e burimeve njerëzore. Gjithashtu, ne kemi edhe dy kritika për sa i përket OSHEE-së, të cilat kanë ndikuar në zbatimin e ndarjes, si dhe në impelementimin e rregullit për vonesën në pagesa nga 20-30 ditë në 180 ditë, ndërsa Autoriteti i Konkurrencës nuk po i zbaton vendimet dhe nuk po merret me sektorin e energjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, Autoriteti i Konkurrencës vetëm po rekomandon veprime, nuk po merr vendime. Fatkeqësisht, Autoriteti i Ndihmës Shtetërore nuk është operativ për shkak të mungesës së stafit dhe pavarësia e tij është e diskutueshme.

Slide –i tjetër ka të bëjë me rezervat e naftës. Direktiva jonë tregon se çdo vend duhet të ketë rezervat e tij të naftës dhe, konkretisht, kjo rezervë duhet të jetë për 90 ditë shitje mesatare ditore.

Projektligji “Për mbajtjen e rezervave të naftës” prej vitesh është në proces përgatitjeje. Tashmë çdo gjë është gati dhe shpresojmë që brenda këtij viti të miratohet. Kolegu ynë në sekretariat, zoti Adrian Jasimi, është personi që merret direkt me rezervat e naftës dhe ka qenë gjithmonë kontribuues në përgatitjen e kuadrit ligjor. Gjithashtu, edhe aktet nënligjore janë gati.

Në sektorin e energjisë së rinovueshme kemi një vlerësim shumë pozitiv për Shqipërinë, sepse është vendi i parë anëtar i Komunitetit të Energjisë, i cili ka organizuar ankande dhe e ka bërë këtë para se ta bëjnë edhe disa vende të BE-së. Në këtë segment jemi shumë pozitivë, por, nga ana tjetër, besimi i investitorëve varet shumë nga mungesa e parashikueshmërisë së kuadrit ligjor. Vitin që shkoi kur kemi miratuar ligjin dhe amendamentet e ligjit “Për sektorin

e energjisë”, ne kemi rënë dakord dhe janë miratuar me ato zgjidhje që janë propozuar, por praktikisht ende nuk janë vënë në zbatim.

Slide –i tjetër është për pjesën e energjisë nga burime të rinovueshme. Ne synojmë që deri në vitin 2020 konsumi i energjisë nga burime të rinovueshme të jetë në masën 38%. Në *slide* ju mund të shikoni se kjo përqindje vitet e kaluara ka rënë dhe kjo rënie nuk varet vetëm nga situata e energjisë hidrike në vend, por edhe nga faktorë të tjerë. Ne shpresojmë që të kemi një situatë pozitive me ankande, ku të reflektohen te mullinjtë e erës dhe tek impiantet diellore, në mënyrë që të nxisim dhe të shtojmë furnizimin me energji nga burime të rinovueshme.

Për sa i takon efikasitetin të energjisë, ne kemi pasur dy direktiva: të eficiencës së energjisë dhe performancën e rrjetit të energjisë. Ne shpresojmë që aktet nënligjore në lidhje me efikasitetin e energjisë të miratohen shpejt në parlament. Afati për traspozimin ka qenë në tetor të vitit 2017.

Krijimi i Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë, së cilës akoma i mungon stafi, është diçka e mirë, por duhet të krijohet edhe fondi për efikasitetin e energjisë.

Për sa i përket mjedisit, Komuniteti i Energjisë ka 7 direktiva, 6 nga të cilat janë transpozuar në Shqipëri. Mungon vetëm sasia e sulfurit në karburante. Në përgjithësi, indeksi i transpozimit në sektorin e mjedisit në Shqipëri është i mirë, por indeksi për implementimin e këtyre transpozimeve nuk është i mirë. Kjo reflektohet te vlerësimi i impaktit mjedisor dhe vlerësimi strategjik i këtij impakti. Kjo është parë edhe nga protestat e ndryshme, që janë bërë për ndërtimin e hidrocentraleve në Shqipëri.

Për sa i përket klimës, mund të themi se Shqipëria është me fat, sepse për prodhimin e energjisë nuk përdor qymyr, që për shumë vende të tjera anëtare të këtij komuniteti është një barrë e rëndë.

Për këtë kemi rënë dakord me Kryeministrin, që Shqipëria të jetë i pari vend anëtar i Komunitetit të Energjisë, që do të miratojë planin e integruar të prodhimit të energjisë. Kryeministri ka firmosur një urdhër, që formalizon ngritjen e një grupi pune. Kjo është bërë në muajin mars të këtij viti. Shpresojmë që grupi i punës të fillojë punë punën dhe ta përgatisë këtë strategji të integruar, ku në të njëjtin dokument përfshihen: prodhimi i energjisë, efikasiteti i saj, mjedisi dhe klima.

Gjithashtu, në Shqipëri po punohet për ligjin për ndryshimet klimaterike. Edhe për këtë dua të them se Shqipëria është vendi i parë i Komunitetit të Energjisë që po ndërmerret këtë hap. Ka pasur disa tentativa edhe në Serbi, por kjo mbetet akoma pezull. Ju nxis të vijoni sa më shpejt me miratimin e këtij ligji!

Këtu dua ta mbyll prezantimin tim. Jam i hapur për pyetjet tuaja.

Niko Peleshi – E falënderojmë drejtorin për prezantimin!

Siç e ndoqët, ishte një guidë shumë praktike e gjithë procesit të Shqipërisë dhe vendeve të tjera anëtare të Komunitetit të Energjisë drejt plotësimit të legjislacionit dhe gjithë kuadrit të nevojshëm për të kënaqur misionin e Komunitetit të Energjisë. Pa dyshim, diku ka progres më të shpejtë, diku jo dhe aq, por ky është një proces. Ne ecim paralel me vendet e tjera dhe me guidën e këshillimit shumë të vyer të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Prandaj, dua ta falënderoj sinqerisht drejtorin, zotin Kopac, për prezantimin!

Kalojmë në diskutime, pyetje, përgjigje apo komente për raportin.

Kemi prezentë disa përfaqësues nga ministria, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), ERE, Agjencia e Eficiencës së Energjisë dhe OST-ja.

Fillimisht do t'ua jap fjalën deputetëve për të bërë pyetje. Më pas, zoti Kopaci ka mirësinë t'u përgjigjet pyetjeve dhe t'i komentojmë ato së bashku.

Do të flasë zoti Baraj dhe më pas zoti Beqaj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Edhe zoti Kopac e përmendi në fjalën e tij, shkarazi, problematikën e hidrocentraleve dhe debateve që bëhen në Shqipëri.

Në Shqipëri ka palë pro dhe kundër ndërtimit të hidrocentraleve të vegjël. Shpeshherë akuzat janë të ndërsjella, për implikime, si të thuash, në konflikte interesi. Jo rrallëherë, në favor të ndërtimit të tyre sillen si shembuj rastet kur edhe në vendet e Bashkimit Europian janë ndërtuar hidrocentrale të vegjël në një fazë ndoshta të hershme, 30 apo 40 vjet më parë.

Unë do ta quaja me vend nëse Sekretariati i Energjisë përfshihet në një analizë të kujdesshme, ku të marrë në konsideratë ekuilibrat mjedisorë, përfitimin nga pikëpamja energjetike dhe humbjen nga pikëpamja e dëmeve që sjell në mjedis.

A mund ta bëni ju këtë rol, si një ekspertizë shumë e kualifikuar, që qëndron mbi palët? Do të ishte një ndihmë shumë e madhe për opinionin shqiptar dhe për ndërtimin e tyre.

Ilir Beqaj – Faleminderit për prezantimin!

Kam një sërë pyetjesh, por çështja më e rëndësishme që dua të diskutoj nuk është në raport, por u prek në fjalën e zotërisë. Kjo çështje ka të bëjë me planet e afërta për organizimin e marrëdhënieve midis OSHEE-së dhe KESH-it.

Dua ta pyes zotërinë: këtë çështje ta lëmë si pikë të parë apo për në fund?

Atëherë, po e lë për në fund këtë çështje, meqenëse mund të jetë një diskutim më i gjatë.

Kuvendi miraton çdo vit rezoluta për disa institucione të pavarura, përfshirë këtu ERE-n dhe Autoritetin e Konkurrencës, që janë dy ente që përfshiheshin në raport.

A njihen ato me këto rezoluta?

A e kanë në praktikën e tyre vlerësimin e rezolutave që bëjmë ne, qoftë për ERE-n, qoftë për Autoritetin e Konkurrencës?

Dakord.

Kthehemi te *slide* 6, te çështja e fundit. Sipas jush, kjo çështje mund të pengojë zhvillimin e tregut. Lidhet me 180-ditëshin e afatit të pagesës.

Marrëdhëniet e pagesave nuk janë marrëdhënie specifike të një tregu energjie, por janë marrëdhënie që i zgjidh legjislacioni tregtar i çdo vendi, jo legjislacioni civil.

Nuk besoj se duhet të kthehemi 30 vjet mbrapa, kur një ent nga sipër caktonte se si i kishin marrëdhëniet tregtare ente të caktuara. Sot mund të jetë OSHEE-ja me operatorë, nesër mund të jenë dy operatorë privatë.

Më kujtohet diskutimi që kemi bërë bashkë vitin e kaluar. Ju na keni thënë se ne akoma vijojmë me një model të vendeve të ish-blokut sovjetik, bëjmë *cross opposite* midis familjarëve dhe biznesit, si dhe mbajmë të ulur çmimin e familjareve për të rënduar biznesin. Vjet na keni thënë se kjo është e gabuar dhe meqenëse vendet e zhvilluara perëndimore kanë ecur në rrugë tjetër dhe kanë pasur rezultat, edhe ju do të keni rezultat. Shumë mirë.

Ju thatë se kushti 180 ditë mund t'i vërë në vështirësi tregtarët e energjisë.

Dua të kuptoj: qëllimi i rregullimit të këtij tregu është çmimi i përballeshëm dhe cilësia e furnizimit për konsumatorët, apo tregtarët e fuqishëm të energjisë?

Nuk mund t'ju jap një informacion të saktë se çfarë po ndodh me tregtarët e energjisë në Shqipëri, sepse po bëj një studim të caktuar. Mund t'ju them me siguri që para 5 vjetësh disa tregtarë të energjisë nuk ishin në 20 apo 30 kompanitë më të mëdha në Shqipëri, por sot kanë hyrë në 10 kompanitë më të mëdha në Shqipëri dhe me norma shumë të larta fitimi. Bravo u qoftë! Nuk kam asgjë me ata që fitojnë. Madje, sa për informacion, ne ia bëmë biznesit dividendin nga 15 në 8. Praktikisht, edhe ato biznese të mëdha shqiptare (janë akoma pak), që po kërkojnë të blejnë vetë energji në treg, rezulton se duhet t'ua blejnë tregtarëve shqiptarë më shtrenjtë seç e merrnin dikur te OSHEE-ja, për të cilën ju na thoshit se është e *cross*-subvencionuar në mënyrë të padrejtë.

Nga njëra anë, duhet ta liberalizojmë tregun, të paktën mbi 6 kilovolt... Është shumë e drejtë. Përderisa gjithë bota ka pasur zhvillim kështu, nuk ka pse të mos kemi edhe ne. Në qoftë se dikur çmimi i energjisë që blinte biznesi privat, ishte i fryrë, sepse subvenciononin familjarët, në tregun e lirë sot është edhe më i shtrenjtë dhe ata nuk duan të ikin; i kërkojnë OSHEE-së të vazhdojë të qëndrojë në sistem. Dua një shpjegim për këtë, duke risjellë në vëmendje që vjet, të njëjtës pyetje, nuk i dhatë përgjigje.

Për sa i përket opinionit të përgjithshëm se çfarë pritet të ndodhë me OSHEE-në dhe me KESH-in, nuk e di nëse është audienca, por unë, si deputet i këtij Kuvendi, e kam ndjekur. Me sa kuptova, më korrigjoni nëse e kam gabim, ju keni një informacion paraprak cila është një nga mundësitë, që ne duam ta bëjmë, por ju nuk e pranoni. Minimalisht, nga informacioni që unë kam, një nga versionet është modeli i Kroacisë së sotme, që është edhe anëtar i BE-së dhe i komitetit tuaj.

Faleminderit!

(Flet anglisht.)

(Diskutime pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Rifillojmë seancën.

Do të vazhdojmë me përgjigjet e zotit Kopac për pyetjet e zotit Beqaj.

Janez Kopac – Faleminderit!

Më parë thashë se Kroacia nuk është një shembull i mirë, por është e rëndësishme të them se afati 180-ditor për pagesat e rrit çmimin për konsumatorin. Mund ta vendosni afatin 180-ditor nëse Shqipëria e prodhon 100% konsumin që ka, por Shqipëria e importon energjinë elektrike dhe, për atë çfarë blejnë tregtarët, duhet të vendosin edhe një tarifë ekstra për vonesat. Kjo e rrit çmimin e konsumatorit.

Ilir Beqaj – Po e ribëj pyetjen.

Nuk është çështja për 8, për 18 apo për 180 ditë. Unë po pyes nëse Rregullatori i Energjisë duhet të hyjë edhe në çështjet komerciale midis palëve? Ditët mund të jenë të ndryshme, nuk jam në gjendje të hyj në aritmetikë. Sigurisht, në kohë, paraja ka kosto, dhe sot nuk dëmton çmimin e konsumatorit, sepse është i rregulluar, por dëmton financat e OSHEE-së, sepse OSHEE-ja detyrohet të blejë më shtrenjtë. Meqë hymë në terma komerciale, edhe nëse OSHEE-ja nuk do të paguajë për 180 ditë, por për 30 ditë, do të gjejë burime të tjera financiare dhe është po ajo kosto. Kjo është *zero sum*, por të mos hyjmë në pjesën financiare.

Janez Kopac – Së pari, OSHEE-ja duhet të ndahet në aktivitete të rregulluara dhe të parregulluara. Kjo duhet të ishte bërë para disa vjetësh, por është shtyrë.

Gjithashtu, duhet që ERE-ja të rregullojë aktivitetet e rregulluara dhe aktivitetet e parregulluara. Aktivitetet tregtare nuk duhet të jenë të rregulluara, sepse për shkak të periudhës së tranzicionit ju duhet të mbani detyrimin publik për konsumatorin ose ndoshta edhe për të gjithë konsumatorin familjar. Ky shërbim i detyruar ka koston e vet dhe kjo kosto do të mbulohet nga financat publike dhe jo nga konsumatorët e tjerë të energjisë dhe për këtë duhet, së pari, të miratohen aktet nënligjore për të kuptuar se cili konsumator fiton në këtë rast. Kjo nuk është bërë ende.

Më pas duhet të përcaktoni burimin që e mbulon këtë humbje të shërbimit publik. Mund të dalë nga KESH-i ose nga ...

Kjo duhet bërë. Për sa kohë nuk janë ndarë dhe i kemi të gjitha në një kosh, do të kemi probleme.

Tani dëshiroj t'i përgjigjem pyetjes së zotit Baraj.

Ai sugjeroi që sekretariati të përfshihet në vlerësimin e projekteve individuale, por fatkeqësisht këtë nuk mund ta bëjmë, pasi jemi 45 persona në sekretariat. Gjithsesi, nuk jemi mjaftueshëm për të mbuluar edhe vlerësimin e projekteve të veçanta.

Ne po përgatisim, dhe besoj se do ta publikojmë në qershorin e këtij viti, një udhëzues të politikave se si t'i trajtojmë impiantet e vogla hidrike. Ajo çfarë mund të rekomandoj tani, bazuar edhe në eksperiencat e vendeve të tjera, është të hiqni dhe të largoni tarifën nxitëse.

Në qoftë se llogarisim përfitimet nga hidrocentralet e vogla, me një, dy, tre megabajt, ato janë aq të ulëta në krahasim me dëmin që bëjnë në mjedis, sa po të heqim edhe këto tarifën nxitëse, nuk rezulton të ketë ndonjë përfitim. Po të shohim edhe rastin e Serbisë, ku kjo çështje politike është shumë e përditshme ashtu si dhe në Shqipëri, investimi në këto hidrocentrale të vogla bazohet tërësisht në këto tarifa nxitëse. Mali i Zi, për shembull, i ka hequr fare këto tarifa mbështetëse, sepse interesi i tyre është të investojnë në impiantet e mëdha të erës, ato diellore, tek energjia e rinovueshme, pasi kjo vjen nga interesi dhe kërkesat e tregut.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit, zoti Kopac!

Kemi pyetje të tjera. Zonja Gjermani dhe zoti Jakimi.

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit!

Ju falënderoj për raportimin! Mendoj se është krijuar një traditë e mirë, sipas së cilës komuniteti i energjisë raporton në komisionin tonë parlamentar. Besoj se ky është edhe një bilanc pune për të gjitha institucionet shqiptare, që merren me energjinë.

Unë kam dy pyetje. E para: meqenëse ky raportim bëhet një herë në vit, dhe ju vini edhe pranë komisionit për ta ndarë me ne këtë informacion, do të doja të dija nëse bëni vlerësime periodike e të ndërmjetme për institucionet shqiptare në fushën e energjisë, për t'i inkurajuar në lidhje me çfarë është bërë mirë, si dhe për të diskutuar se çfarë duhet përmirësuar, me qëllim që raportimi njëvjeçar të jetë pasqyrim i një gjendjeje normale, por ama edhe të keni mundësinë të jepni feedback në mënyrë periodike, jo thjesht një herë në vit.

Për mua është shumë e rëndësishme që, në raportin që ju paraqisni një herë në vit, të ketë një pasqyrë përfshirëse të të gjitha reformave, gjërave që ecin apo nuk ecin në lidhje me energjinë në Shqipëri. Besoj se institucionet shqiptare do ta kishin më të lehtë, nëse kjo do të bëhej jo thjesht një herë në vit, por në mënyrë periodike.

Pyetja e dytë: Si mendoni ju, çfarë ndihme konkrete mund të japë Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese gjatë periudhës njëvjeçare, derisa ju të hartoni raportin tjetër, në të gjitha pikat e dobëta apo problematikat që ju keni vënë re në fushën e energjisë. Siç e tha kolegu Beqaj, ne përgatisim rezoluta për të gjitha institucionet e pavarura që vijnë e raportojnë në komisionin tonë, në lidhje me të cilat unë mbështes idenë se duhet t'i merrni, që ato të jenë pjesë e raportit njëvjeçar që bëni, sepse janë pasqyrë konkrete e arritjeve dhe problematikave të secilit institucion, si dhe janë detyra konkrete, që ne si komision parlamentar u vendosim këtyre institucioneve. Përveç rezolutave dhe monitorimit të veprimtarisë së tyre, a ka diçka tjetër konkrete, qoftë me ndryshime ligjore, qoftë me monitorim të zbatimit të ligjeve apo akteve nënligjore, që ne si komision mund ta bëjmë më mirë, për të dhënë një kontribut më të madh në fushën e energjisë?

Faleminderit!

Halil Jakimi – Në vijim të përgjigjes së dhënë nga komisioneri, unë do të vazhdoj në lidhje me fushën mjedisore. Kam një pyetje të vetme. Duke parë dhe ngjarjet e fundit, dua të ndaloj pak te pjesëmarrja më e mirë publike në vlerësimet mjedisore, tek pjesa e ndërtimit ose e dhënies me koncesion të hidrocentraleve. Shpeshherë kemi parë se i gjithë seti i dokumenteve bëhet pa konsultime publike, arsye për të cilën pastaj, pasi jepet koncesioni, ka një ngërç në zbatim, në implementimin në terren. Mendoj se kjo është e para, pasi vendi ynë është përfshirë shpeshherë në protesta lokale, atje ku ka hidrocentrale të vegjël, me prodhim të vogël të energjisë, por impakti publik ka qenë shumë i madh, gjë që shpeshherë ka sjellë reagimin e njerëzve.

Një problem i dytë, të cilin e kam hasur në ndërtimin e hidrocentraleve, është pjesa ku është ne sanksionuar me ligj, që ndërtimi i hidrocentraleve dëmton një sipërfaqe pyjore të caktuar. Zakonisht, pyjet e larta e kanë raportin e pyllëzimit një me dy, domethënë, veshja e sipërfaqes pyjore. Nëse ai dëmton një hektar, normalisht duhet të pyllëzohet dy hektarë diku tjetër, sipas rekomandimit që jepet nga drejtoria pyjore përkatëse apo bashkia e vendit ku ushtrohet aktiviteti.

Pyetja ime është: çfarë rekomandoni? Sepse shpeshherë biem ndesh me popullin, dhe pasi bëhet seti i dokumenteve pa konsultime publike paraprake, por bie ndesh edhe me këshillat bashkiake të vendeve ku do të ndërtohet hidrocentrali.

Ky është një problem kyç, dhe pavarësisht se shikohet kështu, shpeshherë duket si gjë që krijohet fshehtas. Të paktën kështu është në sytë e publikut, pasi shpeshherë ne nuk jemi në dijeni dhe vendi ynë përfshihet në protesta.

Çfarë rekomandoni ju, dhe si është kjo pjesë në vlerësimin tuaj?

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Së pari falënderoj zotin Kopac për prezantimin që bëri, si dhe për kujdesin që tregon në këto raportime!

Në përgjithësi i dëgjuam fushat në të cilat kishte përmirësime, si dhe ato ku kishte ende detyra për të kryer. Edhe për ne këtu, por në radhë të parë për publikun që na ndjek, do të doja të bëja një pyetje fare të thjeshtë: në këndvështrimin tuaj, nga viti i kaluar e deri sivjet, Shqipëria ka bërë hapa përpara, ka ndenjur në vend apo ka bërë hapa prapa në sektorin e energjisë në përgjithësi?

Niko Peleshi – Kemi pyetje të tjera nga anëtarët e komisionit, nga deputetët?

Zoti Kopac, fjala për ju.

Janez Kopac – Faleminderit!

Faleminderit për pyetjet, të cilat më japin mundësi për ta shpjeguar më në detaje raportin, si dhe për të marrë ide nga ju!

Raporti ynë gjendet online, dhe përditësohet vazhdimisht me zhvillimet e reja në vendet përkatëse. Domethënë, nuk bëjmë thjesht një printim të bukur, por diçka që është gjithmonë online dhe e përditësuar.

Ka raste kur merremi në mënyrë më intensive me vende të caktuara, kështu që vitin e kaluar jemi marrë më intensivisht me Shqipërinë, gjë e cila është bërë sipas rasteve me iniciativë të drejtorit të OSHEE-së, e ndonjëherë me iniciativë të kryetarit të këtij komisioni. Bëhen takime dy herë në vit: një herë në Vjenë e një herë në Tiranë, ku janë të ftuar të gjitha palët e interesuara, dhe ku trajtojmë në mënyrë intensive çështjet që kanë lidhje me energjinë elektrike, e më pak me energjinë e rinovueshme. Rezultati ka qenë se kemi hartuar në sekretariat shtatë akte nënligjore kyçe, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ndryshimin e ministrave entuziazmi në njëfarë mënyre u ngadalësua, ra. E kuptoj që ministrit të ri i duhet kohë për t'u njohur me të gjitha çështjet e hapura. Shpresoj të arrihet kjo gjë.

Ne kemi asistuar për hartimin e disa ligjeve kryesore. Siç e thashë edhe më parë vitin e kaluar kur po hartohej ligji për tregun e energjisë elektrike ne kemi asistuar sidomos tek nene që kishin të bënin me kontratat e vjetra. Kjo gjë mendojmë se aty është zgjidhur. Aktualisht po ndihmojmë për ndryshimet në ligjin për efikasitetin e energjisë. Por praktikat ndryshojnë nga vendi në vend. Kemi shembullin e Ukrainës, ku ministria nuk është funksionale, të paktën në këtë aspekt dhe ne çdo gjë e bëjmë me deputetët, të cilët bëjnë edhe

propozimin e projektligjeve dhe më pas miratimin e tyre. Praktika jonë kryesisht në të gjitha vendet, përfshirë këtu edhe Ukrainën është që fillimisht të punojmë me ministritë që kjo procedurë të përfundojë në parlament.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk përbën ndonjë problem nëse ne ju drejtohem direkt juve për këto çështje. Për mua do të ishte shumë kënaqësi nëse do t'ju informoj më shpesh në mënyrë më të rregullt dhe do të ishte shumë mirë që unë të kem rezolutat që dalin nga parlamenti.

Për pyetjen e zotit Jakimi në lidhje me efektin mjedisor të ndërtimit të hidrocentraleve të vogla, mund të them se çdo projekt i ndërtimit të hidrocentraleve duhet të kalojë fazën e vlerësimit të ndikimit të tij mjedisor dhe ky vlerësim duhet të reflektojë dhe opinionin publik. Kjo është pjesë e direktivës së Komunitetit të Energjisë. Patjetër duhet të ketë konsultime publike dhe t'u jepen përgjigje shqetësimeve apo problemeve që ngrihen në këto konsultime publike. Mund t'ju them një shembull nga Bosnje- Hercegovina ku kishim ankesa nga organizata joqeveritare se vlerësimi për impaktin mjedisor nuk ishte bërë ashtu siç duhej dhe u ndalua ndërtimi i këtij hidrocentrali të madh derisa të bëhej rivlerësimi për impaktin mjedisor. Nëse flasim për projekte të mëdha duhet që edhe ato të kenë vlerësime strategjike për impaktin e tyre në mjedis. Kjo vlen për hidrocentralet e mëdha. Kjo do të thotë që Shqipëria në nivel kombëtar duhet të bëjë një vlerësim të kostove dhe të përfitimit. Më pas të bëjë vlerësimin nëse në përgjithësi ia vlen përfitimi në këtë rast.

Në Shqipëri duhet të bëhet një vlerësim nëse doni ta mbani Vjosën të paprekur apo përfitimet nga ndërtimi i hidrocentralit atje është më i madh sesa mosprekja e saj. Edhe ky vlerësim strategjik për impaktin mjedisor duhet të ketë konsultimet e publikut. Ky vlerësim nuk do të thotë se nuk duhet të bëhet investim, por duhet të merren parasysh të gjitha aspektet dhe të bëhet llogaria, të vihen në peshore të gjitha argumentet dhe kundërgjithësitet. Flas për vlerësimet strategjike dhe për vlerësimet e impaktit mjedisor që kanë të bëjnë me hidrocentralet e vogla.

Zoti Pëllumbi më kërkoi një vlerësim të përgjithshëm për progresin e bërë në lidhje me sektorin e energjisë gjë që fatkeqësisht nuk mund ta bëj, sepse për mua nuk do të ishte shumë serioze. Në fushën e efikasitetit të energjisë gjërat kanë ndryshuar pozitivisht. Po ashtu tek energjia e rinovueshme në sektorin e gazit nuk ka pasur shumë ndryshime. Në sektorin e energjisë elektrike ka pasur progres me zhvillim pozitiv dhe negativ, pra gjërat nuk mund t'i përgjithësoj. Meqenëse parlamenti është më i përgjithshëm, ne po flasim në terma më të përgjithshëm. Dua të them se në përgjithësi është bërë shumë punë, si nga ana e qeverisë, ashtu

edhe nga ana e Sekretariatit ku po diskutojmë për detaje në mënyrë që të ecin gjërat më pozitivisht.

Niko Peleshi - Shumë faleminderit për përgjigjet shteruese, zoti Kopac!

Ka pyetje të tjera nga anëtarët e komisionit? A ka pyetje apo ndonjë koment nga përfaqësuesit e ministrisë apo të institucioneve të tjera? Ju lutem shkurt!

Po, zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti – Falënderoj zotin Kopac për raportin dhe për problematikat që trajtoi!

Pavarësisht se ne jemi në një kontakt të përhershëm me Sekretariatit dhe në përgjithësi kemi një praktikë shumë pozitive, ku të gjitha vendimet dhe aktet nënligjore që miratojmë i konsultojmë së pari me Sekretariatit dhe marrim qëndrimin, vërejtjet apo komentet e tyre. Në këtë këndvështrim unë shikoj një bashkëpunim shumë të frytshëm deri tani.

Në raport pamë edhe vlerësimin që lidhet me sektorin e energjisë, në mënyrë specifike me pozicionin e rregullatorit, por dua të shkëpus vetëm një moment, i cili u trajtua më parë, i cili lidhet me një vendim që kemi marrë ne për Operatorin e Shpërndarjes, për blerjen e energjisë elektrike dhe për afatet kohore, të cilat janë vendosur. Ky është një vendim i përkohshëm. Unë dua ta cilësoj që në fillim, sepse lidhet me një situatë relativisht të vështirë financiare të Operatorit të Shpërndarjes dhe në vendimin specifik që kemi marrë janë përshkruar të gjitha kushtet dhe rrethanat në të cilat do të veprohet, duke nënvizuar një barazi në pagesat që do të bëhen për operatorët dhe për tregtarët nga kompania. Pra, dua të theksoj se është një vendim i përkohshëm.

Unë jam dakord me pozicionin dhe vendimin që shprehu zoti Kopac, që është një marrëdhënie shumë e rëndësishme tregtare, por përkohshmëria e vendimit nuk cenon të gjithë idenë dhe bazën legjislative mbi të cilën ai është marrë.

Për sa u përket problematikat e tjera të trajtuara që lidhen me sistemin e rregullimit, unë jam plotësisht dakord me sa është paraqitur në raport. Ka një progres të dukshëm nga ana e institucionit rregullator dhe është ndjekur çdo zhvillim i tregut, qoftë i energjisë elektrike, por kohët e fundit edhe i gazit natyror që është krijuar bazë e legjislacionit sekondar shumë e përshtatshme e gjitha, si dhe e akorduar me legjislacionin e BE-së. Pra, nga kjo pikëpamje do të thosha ne kemi çfarë të themi në lidhje me arritjet e deritanishme të rregullatorit. Kjo edhe falë bashkëpunimit që kemi me Sekretariatit e Vjenës Bashkohem me konkluzionet që zoti Kopac dha në lidhje me pozicionin e Entit Rregullator dhe forcimin nga pikëpamja edhe e kapaciteteve të Entit Rregullator, sepse në analizën e fundit një rregullator është i fortë kur ai është i përgatitur nga pikëpamja profesionale, sepse edhe vendimet që dalin lidhen drejtpërdrejt me këtë lloj përgatitjeje.

Në lidhje me klasifikimin midis vendeve, natyrisht, unë e kuptoj se zoti Kopac nuk mund të bëjë një vlerësim të kësaj natyre, por, praktikisht, ne në marrëdhëniet që kemi me rregullatorët e rajonit, kemi një vlerësim shumë pozitiv dhe kjo falë edhe punës dhe serioziteti së Rregullatorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror.

Vendimi i Entit Rregullator është një vendim i cili është i përkohshëm. Nuk ka të bëjë me respektimin e bazës legislative apo me elemente të tjera të kësaj natyre, që krijojnë edhe pjesën e diskriminimit.

Në analizë të fundit një rregullator ka detyrën kryesore të ekuilibrojë interesat e pjesëtarëve të tregut të energjisë elektrike, por gjithsesi kemi parasysh edhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve që shprehen nëpërmjet aktivitetit të kompanisë.

Unë nuk dua të zgjatem më tepër sepse ne do të vijmë pas pak ditësh për të paraqitur raportin vjetor të aktivitetit të rregullatorit, i cili bëhet publik dhe është i njohur edhe për sekretariatit e komunitetit të energjisë.

Së fundi, dua të falënderoj zotin Kopac për problematikën dhe mënyrën se si e trajton atë, dua të vlerësoj punën e komisionit për këtë bashkëpunim me Sekretariatit, sepse në analizë të fundit është edhe një ndihmë shumë e madhe për ne si institucione të pavarura që lidhemi drejtpërdrejt me sektorin e energjisë, në mënyrë specifike me atë të energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Ahmeti!

A ka ndonjë koment tjetër nga përfaqësuesit e ministrisë apo OST-së?

Agim Bregasi – Falënderoj edhe unë drejtorin ekzekutiv të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjenë për raportin, për prezantimet shumë konciz, por me problematikën që është hasur në sektorin e energjisë në Shqipëri dhe natyrisht bashkëpunimi i ministrisë me këtë sekretariat ka qenë shumë i ngushtë në përpjekjet tona për përafrimin e kuadrit ligjor, atij primar dhe atij sekondar. Bashkëpunimi me sekretariatit ka qenë shumë i frytshëm, jo vetëm me ardhjet e specialistëve, por edhe me komentet e shpeshta që ata bëjnë për problemet tona.

Njëkohësisht dua të vlerësoj nga ana ime edhe këtë lloj komunikimi që ka sekretariatit me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, i cili për sektorin tonë është komisioni kryesor.

Dua të them që ne kemi programuar punën dhe bashkëpunimin me sekretariatit për të shamgur të gjitha vonesat që u përmendën në raport dhe për të pasur një përafrim të plotë të legjislacionit tonë primar dhe sekondar, por edhe të organizmit të kompanive tona, sipas paketës së tretë, të cilat i përmendi edhe raporti.

Edhe një herë dua të falënderoj duke shpresuar që gjërat do të shkojnë akoma më mirë.
Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Erion!

Erion Tase – Mirëdita!

Unë jam Erion Tase nga Akademia e Studimeve Politike. Është viti i dytë që ne jemi pjesë e këtij raportimi të Komunitetit të Energjisë dhe me zotin Kopac kemi bashkëpunim të frytshëm në pjesën e bashkërendimit të parlamentarëve të rajonit për të incentivuar angazhimin e tyre në fushën e eficiencës së energjisë.

Në përgjigje edhe të sugjerimit të zonjës Gjermani do të thosha se ne mund t'ju vëmë në dispozicion një monitorim të pavarur, që është bërë nga ekspertë të pavarur mbi zbatimin e akteve nënligjore. Është një monitorim që vazhdon për ministrinë dhe institucionet e linjës dhe që është bashkërendues me raportimin vjetor që zbatohet edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Do të jemi bashkërisht edhe ditën e martë, më 23 prill, në një tjetër aktivitet, ku Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, i cili është një nga komisionet më aktive do të jetë i përfshirë në fushën e eficiencës së energjisë dhe të mobilitetit urban.

Faleminderit!

Janez Kopac – (*Flet anglisht.*)

Dua të them, gjithashtu, se ne do të organizojmë në Chisinau, Moldavi, plenumin, asamblenë parlamentare ku do të jenë edhe dy deputetë përfaqësues.

Dëshiroj t'ju falënderoj që me lejuat të jem me ju. Pa ju, domethënë pa vendet anëtare, palët e interesuara, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nuk do të ekzistonte.

Më pëlqen gjithmonë të them që suksesi juaj është suksesi jonë dhe le ta bëjmë këtë një sukses të përbashkët.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Kopac!

Edhe në emër të të gjithë anëtarëve të komisionit sinqerisht ju falënderoj për prezantimin e raportit dhe për gjetjet e tij. Padyshim, kur ka vlerësime, gjithmonë ka edhe këndvështrime të ndryshme, por e rëndësishme është që ky raport është një gjuhë dhe ngacmon nervin e punës tonë në bashkëpunim dhe si pjesë e komunitetit të energjisë për të arritur objektiva dhe për të zbatuar reformat e parashikuara në këtë kuadër.

Siç e pamë, ka disa fusha ku kemi progres më të mirë, krahasuar edhe me vendet e tjera, madje edhe me vendet e BE-së, siç është ankandi i organizuar për energji të rinovueshme, që u përshëndet edhe nga zoti Kopac në prezantimin e tij, por ka edhe fusha të tjera ku na duhet më shumë impenjim edhe nga ekzekutivi, edhe nga parlamenti dhe ky është një nga komisionet më të rëndësishme për të shtyrë përpara punët.

E rëndësishme është se ka një vullnet politik të fortë për të reformuar të gjitha sistemet në Shqipëri. Sistemet për të cilat po flasim janë të rëndësishme, por, gjithashtu, janë pjesë e të gjithë mentalitetit tonë reformues, kështu që të gjitha institucionet e kanë mbështetjen për të ecur më shpejt përpara.

Ky raport na vlen për të përcaktuar hapat në vazhdim dhe për të nxjerrë detyra secili sipas fushës së vet të përgjegjësisë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA